

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Ministri Gogu në Seancë Plenare: Paga e gjyqtarit caktohet vetëm me ligj, jo me akte të Këshillave apo Qeverisë. Replikë edhe opozitës: Ndërroni qëndrime sipas interesit të ditës
ADRESA	https://www.gazetatema.net/politika/ministri-gogu-ne-seance-plenare-paga-e-gjyqtarit-cak-tohet-vetem-me-ligj-i586773
BURIMI	gazetatema.net
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	17 shtator 2026, 20:14:23 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	17 shtator 2026, 20:06:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	5b765ac39359c051c25b3479341ac7609bfabfd97b58a2fb8d8e7bac981f67e3
TEKSTI	22a0915f2dcb9651f9e4280e8eee5e44a5fdce07875edd3cfd28426c8ce8935
PAMJA	6f4fdd978e29b43807052e0bb358576f948afab359d1049c0805be8b75e20ecf

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	a7191e0c7446e7a425c37a561a13e38c28d046f254a295ff2cdfda9895f8510c
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	3b121f0f38f9983afad61fe399871208f196860b9a8965bfd896e6b91a545c4e
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/a7191e0c7446e7a425c37a561a13e38c28d046f254a295ff2cdfda9895f8510c

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



- [Politika](#)
- [Sociale](#)
- [Kronika](#)
- [Ekonomia](#)
- [Editorial](#)
- [Antena](#)
- [Blog](#)
- [Rajoni](#)
- [Bota](#)
- [Kulturë](#)
- [Sport](#)
- [Lifestyle](#)

 [English](#)

Built and Monetized by 

[Kontakt](#)



 [English](#)



1 e [Pese te vrare nga 'lutta me drone' mes Arabise Saudite dhe rebeleve HouthisMinistri Gogu ne Seance Plenare: Paga e gjyqtarit caktohet vetem me ligj, jo me akte te Keshillave apo Qeverise. Replikë edhe opozitës: Ndërroni qëndrime sipas interesit të ditës](#) fundit

Ministri Gogu në Seancë Plenare: Paga e gjyqtarit caktohet vetëm me ligj, jo me akte të Këshillave apo Qeverisë. Replikë edhe opozitës: Ndërroni qëndrime sipas interesit të ditës



17 Shtator 2026, 22:06Politika TEMA



Ministri Toni Gogu deklaroi sot në Kuvend se parlamenti ka dy detyra njëherësh, të mbrojë pavarësinë e drejtësisë dhe mbrojë çdo lekë të qytetarit që e paguan atë drejtësi. Ai theksoi se kush zgjedh vetëm njërin detyrë, nuk zgjidh asgjë, por vetëm e zhvendos problemin.

Gogu iu drejtua edhe përfaqësueses së opozitës, duke e akuzuar për ndryshime të shpeshta të qëndrimeve. Sipas tij, opozita nuk niset nga pyetja çfarë është e drejtë, por nga pyetja çfarë i duhet asaj sot.

'Sot Kuvendi ka dy detyra, jo një. Të mbrojë pavarësinë e drejtësisë. Dhe të mbrojë çdo lekë të qytetarit që e paguan atë drejtësi. Kush zgjedh vetëm njërin, nuk ka zgjidhur asgjë. Ka zhvendosur problemin. Dhe nis nga pyetja që i paraprin të gjithave: kush e ka kompetencën ta bëjë këtë? Përgjigjen nuk e jap unë. E jep dispozitivi i vendimit, pika e tretë, me fjalë që nuk lënë hapësirë interpretimi: detyrimin e Kuvendit të miratojë ndryshimet ligjore të nevojshme. Jo të Këshillave. Jo të Qeverisë. Jo të Ministrisë. Ky rregull nuk u shkrua për ta kufizuar gjyqësorin. U shkrua për ta mbrojtur. Sepse ajo që sot jepet me një akt jashtë ligjit, nesër merret me një akt tjetër jashtë ligjit. Kur themi se paga caktohet me ligj, ne nuk po mbrojmë pushtetin e Kuvendit. Po mbrojmë gjyqtarin nga çdo qeveri, nga çdo ministër, nga çdo shumicë, përfshirë këtë'.

Ministri ju drejtua dhe përfaqësueses të opozitës lidhur me qëndrimin e tyre për këtë çështje.

'Kenë ndërruar kryetarë. Kenë ndërruar aleanca. Kenë ndërruar qëndrime për të njëjtat institucione dy herë brenda një mandati, dhe ndoshta do t'i ndërroni sërish nesër. Ajo që nuk ka ndryshuar kurrë është pyetja nga e cila niseni: jo "çfarë është e drejtë", por "çfarë më duhet mua sot". Orientimi me hënë ka një problem praktik: ecën, por vjen vërdallë. Pas dhjetë vjetësh rrotullimi, njeriu e gjen veten aty ku nisi, duke pyetur pse nuk mbërriti askund'.



Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

["U përdoqa dhe u fyeva" - Deputetja Luarasi flet për videon e sulmit verbal: 730 komente që flisnin për varje dhe pushkatim](#)

21:50 Politika

Tabaku në Kuvend: Paratë dhe asetet publike nuk mund të administrohen pa transparencë

21:40 Politika

Pagat e magjistratëve/ Bylykbashi prezanton draftin e PS: Rritje sa 2% e pagës së Presidentit

21:30 Politika

20:50 Politika / 4 komente

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.